

20151474162

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PAGESË TË PENSIONEVE
DHE KOMPENSIMEVE TË PENSIONEVE TË SIGURIMIT PENSIONAL ME
FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për pagesë të pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve të sigurimit pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 11/12), në nenin 82 në paragrafin (1) fjalët: "2 000 deri në" shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së matur për shoqërinë për sigurim do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në shoqërinë e sigurimit."

Neni 2

Në nenin 83 në paragrafin (1) fjalët: "10 000 deri në" shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së matur për shoqërinë për sigurim do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në shoqërinë e sigurimit."

Neni 3

Në nenin 84 në paragrafin (1) fjalët: "30.000 deri në" shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 30% te gjobës se matur për shoqërinë për sigurim do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës ne shoqërinë e sigurimit."

Neni 4

Në nenin 85 në paragrafin (1) fjalët: "2 000 deri në" shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së matur për shoqërinë pensionale do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në shoqërinë e sigurimit."

Neni 5

Në nenin 86 në paragrafin (1) fjalët: "10 000 deri në" shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shume prej 30% të gjobës së matur për shoqërinë pensionale do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në shoqërinë e sigurimit."

Neni 6

Në nenin 87 në paragrafin (1) fjalët: "30 000 deri në" shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së matur për shoqërinë pensionale do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në shoqërinë e sigurimit."

Neni 7

Ne nenin 88 në paragrafin (1) fjalët: "5 000 deri në" shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së matur për shoqërinë e përfaqësimit në sigurim ose për shoqërinë brokere të sigurimit do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në shoqërinë e përfaqësimit në sigurim ose në shoqërinë brokere të sigurimit."

Neni 8

Në nenin 89 në paragrafin (1) fjalët: "10 000 deri në" shlyhen.

Paragrafët (2) dhe (3) ndryshohen si vijojnë:

"Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së matur për Fondin e SPIM do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në Fondin e SPIM.

Për kundërvajtjet e parapara në paragrafin (1) të këtij neni organ kompetent për udhëheqjen e procedurës për kundërvajtje dhe shqiptim të sanksionit për kundërvajtje është gjykata kompetente."

Neni 9

Pas nenit 89 shtohet nen i ri 89-a, si vijon:

"Neni 89-a

Matja e lartësisë së gjobës për personin juridik bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje."

Neni 10

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për pagesë të pensioneve dhe kompensimeve pensionale të sigurimit pensional me financim kapital.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".